

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Auron Tare: Së pari duhet ndërgjegjësim për të kuptuar rëndësinë e arkeologjisë nënujore                                                                                                                                                              |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/kulture/auron-tare-se-pari-duhet-ndergjegjesim-per-te-kuptuar-rendesine-e-arkeol-i588035">https://www.gazetatema.net/kulture/auron-tare-se-pari-duhet-ndergjegjesim-per-te-kuptuar-rendesine-e-arkeol-i588035</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                        |
| GJENDJA | redirected                                                                                                                                                                                                                                            |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 24 shtator 2026, 07:19:11 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 08:14:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | c14d745cc05465707a548e5d0c24f347816ee56dcb24745e1019a3b1ad3b6720 |
| TEKSTI     | c9fab6215a4833830b32a6ae2cce511d2f276b8caeb16686808714626b99260f |
| PAMJA      | e4cd81570754ccc3cd22b3e68cc8bee6de44314196174c5e06b3bdd6fc51c5ec |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | e42aeed63b4fbabba293226754d41040258a76a86259d2b665de14e66636faa7                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 1057a6098f5231b1a7fb769cdeef6f94e5e01b8f35ccfb6287a805b5f635f739                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e42aeed63b4fbabba293226754d41040258a76a86259d2b665de14e66636faa7>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English



ie [Kadastra dere me dere ne Himare, evidentohen 235 banesa pa dokumentacion pronesi](#) [Zbulime te rendesishme arkeologjike ne Tepelene](#) [Presidenti sirian thubon 'I rrur fundit](#)

## Auron Tare: Së pari duhet ndërgjegjësim për të kuptuar rëndësinë e arkeologjisë nënujore



24 Shtator 2026, 10:14Kulturë TEMA



Krahas nëntokës, një pasuri e madhe arkeologjike për vendin tonë fshihet nën ujërat e deteve dhe liqeneve. Por rrënojat që ruajnë dëshmi të së shkuarës mbeten të pazbuluara.

*“Që nga 2000 nuk janë zhvilluar më ekspedita”,* tha studiuesi Auron Tare.

Së pari duhet ndërgjegjësim për të kuptuar rëndësinë e arkeologjisë nënujore, thotë studiuesi Auron Tare.

*“Ne jemi popull shumë detar dhe çdo gjë që gjejmë në det, mund ta marrim. Nuk të thotë gjë njeri, edhe polici po të pa. Nuk e kemi kulturën e rëndësisë që ka kjo trashëgimi nënujore”,* tha studiuesi Auron Tare.

Janë dhjetëra anije të fundosura në brigjet shqiptare, disa prej të cilave mbi 2000-vjeçare, ndërsa të tjera mjete lundruese të luftës e më vonë. Pjesa më e madhe në ishullin e Korfuzit, tregon arkeologu Neritan Ceka.

*“Anije që vinin nga Korkyra për të shkuar në Italinë e Jugut apo në drejtim të Durrësit, Apolonisë e Dalmacisë. Në dalje, kush ka bërë pushime e di fare mirë që drekë kthehen era dhe fryn fuqishëm, duke ngritur dallgë të jashtëzakonshme”,* tha arkeologu Neritan Ceka.

*“Të gjitha materialet që ne kemi, që janë me mijëra orë filmime apo fotografitë, nuk kemi ku i shfaqim”,* tha studiuesi Auron Tare.

Në një konferencë në Akademinë e Shkencave, Auron Tare kërkoi vijimin e ekspeditave nënujore dhe mbrojtjen ligjore të zonave ku ka zbulime.

*“Mbrohën me kuadrate që i jepen rojes bregdetare dhe aty nuk lejohet asnjë anije të qëndrojë. Dhe roja bregdetare e kontrollon. Kroacia, për shembull, përdor kafazë hekuri dhe këto zona mirëmbahen e mbrohën nga shteti”,* tha studiuesi Auron Tare.

Shqipëria nuk ka ende një muze të dedikuar vetëm për arkeologjinë nënujore, ndërsa studiuesit propozojnë ide konkrete...

*“Ka një mënyrë kur ti ke një ekran shumë të madh dhe vijnë njerëzit shikojnë live se çfarë po ndodh poshtë. Shembull është Bodrumi, që i gjithë zbulimi prezantohet i plotë me të gjitha objektet që janë gjetur”,* tha studiuesi Auron Tare.

"Nëse ne nuk ndërtojmë muzeun me laboratorin, besoj se do gjejmë vetëm copa qeramike, asgjë tjetër", tha arkeologu Neritan Ceka. A.K./TemA

 Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

A mund të jesh IMUN ndaj vetmisë?

20:17 Kulturë

## Gonxhja: Restaurimi i Teqesë së Koshtanit është detyrim shtetëror

17:41 Kulturë / 2 komente

Karikatura e ditës: Gjeni diçiturën

17:20 Kulturë / 17 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.